




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.78/24

Datë: 09.09.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 09.09.2024, mori këtë;

## V E N D I M

**I. LEJOHET**, Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e drejtpërdrejtë të aksioneve dhe marrjen e kontrollit nga ALFI Renewables d.o.o, mbi Supernova Čazma dhe SN Dubica, dhe në mënyrë indirekte mbi Čazma energija dhe Dubica Energija (kompanitë e synuara),

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 22.07.2024, me Nr. Prot. 469/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerja e drejtpërdrejtë të aksioneve dhe marrja e kontrollit nga ALFI Renewables d.o.o, mbi Supernova Čazma dhe SN Dubica, dhe në mënyrë indirekte mbi Čazma energija dhe Dubica Energija (kompanitë e synuara).

### Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 07.08.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 08.08.2024
3. Palët kanë nënshkruar Marrëveshjen lidhur me blerjen e aksioneve dhe kontrollit të vetëm Supernova Čazma dhe SN Dubica, dhe në mënyrë indirekte mbi Čazma energija dhe Dubica Energija (kompanitë e synuara).

### **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshjen lidhur me blerjen e aksioneve dhe kontrollit të vetëm Supernova Čazma dhe SN Dubica, dhe në mënyrë indirekte mbi Čazma energija dhe Dubica Energija (kompanitë e synuara).

### **Palët në transaksion:**

**ALFI Renewables, upravljanje alternativnih investicijskih skladov, d.o.o.**, kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me adresë të regjistruar në Rrugën Verovškova u55A, 1000 Ljubljana, Republika e Sllovenisë, e regjistruar pranë Regjistratit Gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Ljubljana, me numër të identifikimit 8775958000 (blerësi 1). ALFI Renewables është një kompani sllovene e angazhuar në menaxhimin e fondeve të investimeve alternative, e inkuorporuar në fund të vitit 2020, me aktivitetin kryesor të regjistruar afarist - menaxhimin e fondeve. ALFI Renewables menaxhon fondin special të investimeve ALFI sklad zelenih virov energije, Specialni investicijski sklad, me adresë të regjistruar në rrugën Verovškova 55A, 1000 Ljubljana, Republika e Sllovenisë me numër të regjistrimit 8775958001 ("ALFI Green Energy Fund"), e angazhuar në aktivitetet e investimit në centralet e erës që gjenerojnë energji elektrike nëpërmjet transformimit të energjisë së erës dhe dritës së diellit si burime të ripërtrishme natyrale, kryesisht në fazën e ndërtimit/faza e fundit e zhvillimit. Rajoni i synuar kryesor përfshin Slloveninë, Kroacinë dhe Serbinë. ALFI Renewables dhe ALFI Green Energy Fund janë pjesë e Alfi Group ("Alfi Group") dhe konsiderohen si kompani të ndërlidhura, nën kontrollin dhe pronësinë e të njëjtit aksionar.

**SUPERNOVA ČAZMA D.O.O.** (më herët e njohur si SN SISAK PV d.o.o), kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Kroacisë, me adresë të regjistruar në Avenija Većeslava Holjevca 62, Zagreb, Republika e Kroacisë, e regjistruar në Regjistrin e Komerciale të Gjykatës Komerciale të Zagrebit me numrin e regjistrimit 081544156. **Supernova Čazma** (ish- SN SISAK PV d.o.o.), është një mjet për qëllime të veçanta i krijuar më 3 tetor 2023, në Republikën e Kroacisë, me aktivitet kryesor biznesor prodhimin e energjisë elektrike (kodi i aktivitetit: 35.11). Supernova Čazma aktualisht është në pronësi të **Supernova Beteiligung GmbH**, me selinë e saj të regjistruar në Conrad von Hötzendorf Strasse 99, Graz, Republika e Austrisë, e regjistruar në Gjykatën Themelore në Graz me numrin e regjistrimit FN 459234 ("**Supernova**") dhe **Impact Beteiligung GmbH**, me selinë e saj të regjistruar në Conrad von Hötzendorf Strasse 99, Graz, Republika e Austrisë, e regjistruar në Gjykatën Themelore në Graz me numrin e regjistrimit FN 519940. Si kusht për blerjen e 100% të aksioneve në Kompaninë e Synuar Supernova Čazma nga Parashtruesit e Kërkesës, Supernova

Čazma, menjëherë para zbatimit të Transaksionit të Propozuar, do të blej 100% të aksioneve në kompaninë Čazma energjia nga aksionari i vetëm i shoqërisë. Čazma energjia u themelua më 24 mars 2023 dhe ka zhvilluar projektin e termocentralit diellor “Čazma” në qarkun Bjelovar-Bilogora, Republika e Kroacisë, me një kapacitet lidhjeje të parashikuar prej 90 MW. Čazma energjia zotëron asete, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e termocentralit diellor “Čazma”. Megjithatë, Čazma energjia nuk është ende aktive në treg, nuk ka kapacitet të instaluar dhe nuk ka gjeneruar asnjë qarkullim, por pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit diellor “Čazma”, do të angazhohet në funksionimin e termocentralit diellor. dmth, prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike të prodhuar nga energjia diellore në Republikën e Kroacisë.

SN DUBICA d.o.o. (më herët e njohur si SN SISAK PV II d.o.o.) kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Kroacisë, me adresë të regjistruar në Avenija Većeslava Holjevca 62, Zagreb, Republika e Kroacisë, e regjistruar në Regjistrin e Gjykatës Komerciale të Gjykatës Komerciale të Zagrebit me numrin e regjistrimit 081544236 (“SN Dubica”). Si kusht për blerjen e 100% të aksioneve në Kompaninë e Synuar SN Dubica nga Parashtruesi i Kërkesës, SN Dubica, menjëherë para zbatimit të Transaksionit të Propozuar, do të blej 100% të aksioneve në kompaninë Dubica energjia nga aksionari aktual dhe i vetëm i kompanisë. Dubica energjia u themelua më 15 qershor 2023 dhe ka zhvilluar projektin e termocentralit diellor “Dubica” në Qarkun Sisak-Moslavina, Republika e Kroacisë, me një kapacitet të parashikuar kyçjeje prej 90 MW. Dubica energjia nuk është ende aktive në treg, nuk ka kapacitet të instaluar dhe nuk ka gjeneruar asnjë qarkullim, por pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit diellor “Dubica”, do të angazhohet në funksionimin e termocentralit diellor, dmth, prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike të prodhuar nga energjia diellore në Republikën e Kroacisë.

### **Tregu Relevant:**

Tregu i produktit: tregu për prodhimin dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike.

Tregu gjeografik: në transaksionin e propozuar do të jetë tregu i Kroacisë.

### **Analiza e konkurrencës**

Sa i përket tregut të energjisë së ripërtëritshme dhe investimi në këtë sektor. Alfi Group planifikon të vazhdoj zhvillimin e projekteve të termocentraleve diellore “Čazma” dhe “Dubica” përmes Kompanive të Synuara të cilat do të realizohen në territorin e Republikës së Kroacisë. Konkretisht, kompanitë e synuara do të angazhohen në projektimin, ndërtimin, zhvillimin dhe menaxhimin e këtyre termocentraleve diellore. Në këtë drejtim, Transaksioni i Propozuar përfaqëson një mundësi investimi strategjike tërheqëse për Alfi Group, në përputhje me planet e tij afatgjata për sektorin e energjisë së rinovueshme. Me investimin e propozuar, Alfi Group do të vazhdoj zgjerimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese në industrinë e energjisë së rinovueshme në Republikën e Kroacisë. Njohuritë e specializuara të Alfi Group në Tregun i burimeve të ripërtëritshme të

energjisë, energjinë e ripërtrishme nga investime të mëparshme të ngjashme do të rrisin aktivitetet e Kompanive të synuara dhe do t'u mundësojnë atyre të shfrytëzojnë potencialin që do të ketë energjia e rinovueshme në të ardhmen. Prandaj, Alfi Group pret që zbatimi i projekteve të termocentraleve diellore të gjeneroj vlerë të shtuar të konsiderueshme për sektorin e energjisë së rinovueshme në Republikën e Kroacisë dhe investimi në këtë industri do të jetë i një rëndësie të madhe për prodhimin e qëndrueshëm të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme (energja solare). Prandaj, projektet e energjisë diellore do të gjenerojë vlerë të shtuar të fortë për sektorin e energjisë së ripërtëritshme. Duke pasur parasysh që Alfi Group nuk është prezentë në asnjë formë në tregun e energjisë në Republikën e Kosovës, po ashtu edhe kompanitë e synuara nuk kanë ndonjë prezencë në tregun përkatës të Kosovës, ky transaksion nuk përbën shqetësim për konkurrencën në tregun e Republikës së Kosovë.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se Aplikuesi është pjesë e Alfi Group i cili realizon të hyra përmes kompanive të ndërlidhura në Republikën e Kosovës. Transaksioni i propozuar nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën. Duke pasur parasysh që, asnjë palë nuk është e pranishme në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, ndërsa njëri nga parashtruesit e kërkesës realizon të hyra në Kosovë përmes kompanive të ndërlidhura e që është e papërfillshëm në tregun. Ndërsa Kompanitë e synuara nuk janë fare aktive në Kosovë, andaj transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalim, kufizimi apo shtrembërimi i konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese dhe nuk do të ketë asnjë efekt negativ në tregun kosovar. Bazuar në sa më sipër, rezulton se transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë dhe se është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga "Njoftimi" nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI**



Nejme Bimaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Nënkryetare

Nafije Osdataj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva